



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02.Nr. 8157 /2020

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës nr 03/L-040 neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës dhe nenin 58 Përgjegjësitë e kryetarit ,Ligjin për zyrtarët publik nr 06/L-114 neni 49 Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor paragrafi 1 Rregulloren nr 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik neni 10 dhe 11 , Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M
MBI FORMIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR

1. Formohet Komisioni Disiplinor me mandat **3 vjeçar** në kuadër të institucionit të komunës së Hanit të Elezit i cili ka këtë përbërje:

1.1 **Bajrush Laqi** –(Shef i zyrës ligjore dhe përfaqësues juridik)-**Kryesues i Komisionit**

1.2 **Fatbardha Bushi** – (Inspektore Sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit)-**Anëtare e Komisionit**

1.3. **Mevlud Brava** (Zyrtar për rendin komunal dhe i autorizuar që të kryej disa detyra shtesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore përkatësisht Zyrën e Personelit pranë Administratës Komunale)-**Anëtar i Komisionit.**

2. Detyrë e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi është pranimi, shqyrtimi i fakteve dhe provave lidhur me shkeljet disiplinore të supozuara, vendosja në bazë të provave të shqyrtuara nëse është bërë ose jo shkelja disiplinore si dhe zbatimi i plotë i Ligjit dhe Rregullos nr 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

3. Me hyrjen ne fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr. 02/10208 i datës 14.11.2019

Vendimi t'u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Anëtarëve të Komisionit,
- Drejtorëve të Drejtorateve,
- Zyrës së Personelit dhe
- Arhivës.

Data :04.11.2020
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rifki Suma